



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 593/4 Prot.,

Tiranë, më 29.09.2020

V E N D I M

Nr.97, datë 29.09.2020

“Mbi përfundimin e procedimit administrativ për rikthimin e nëpunësit ** , në pozicionin e mëparshëm të punës, pas përfundimit të periudhës së pezullimit”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 79 – 90, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e informacionit të protokolluar pranë Komisionerit me nr. 593 prot., datë 09.07.2020, për disa pretendime për paligjshmëri, të ngritura nga ankuesi ***** , në lidhje me procesin e rikthimit të tij, në pozicionin e mëparshëm të punës, pas përfundimit të periudhës së pezullimit,

VËREJ SE:

Shtetasi ***** , nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 593 prot., datë 09.07.2020, ka ngritur disa pretendime për parregullsi dhe shkelje të lejuara në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë procesit të rikthimit të tij, në pozicionin e mëparshëm të punës, pas përfundimit të periudhës së pezullimit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur gjatë hetimit administrativ të çështjes, ka rezultuar e vërtetuar se nëpunësi ***** , me shkresën nr. 1089 prot., datë 14.06.2019, “Kërkesë për rikthimin si nëpunës civil në pozicionin e mëparshëm të punës ose transferimin në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori”, i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike, në rolin e njësisë përgjegjëse, rikthimin në pozicionin e mëparshëm

të punës, ose transferimin në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori, nëse ai pozicion është zënë në mënyrë përfundimtare.

Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 3639 prot., datë 18.07.2019, *“Kthim përgjigje”*, ndër të tjerat është shprehur se: *“Referuar pikës 18, të kreut II, të Vendimit nr. 124, datë 17.02.2016 të Këshillit të Ministrave “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, në momentin e krijimit të një pozicioni të lirë në shërbimin civil, njësia përgjegjëse është e detyruar të nxjerrë aktin e transferimit në këtë pozicion për njërin nga nëpunësit e regjistruar në listën që plotëson kriteret e veçanta të vendit vakant”*.

Nisur nga sa më sipër kërkuesi ***** ka pretenduar se, në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, ka vende vakante për të cilat ai plotëson kriteret e veçanta, por meqënëse nuk janë kryer veprime aktive nga ana e njësise përgjegjëse, ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit, për krijimin e mundësisë së rikthimit të tij në pozicionin e mëparshëm të punës, ose transferimin në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori, nëse ai pozicion është zënë në mënyrë përfundimtare.

Për verifikimin e pretendimeve të mësipërme, nëpërmjet shkresës nr. 593/1 prot., datë 17.07.2020, *“Kërkim dokumentacioni për verifikimin e kërkesës së paraqitur nga nëpunësi ***** , për rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës ose transferimin në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori”*, Komisioneri ka kërkuar nga Departamenti i Administratës Publike (njësia përgjegjëse), që të dërgojë të gjithë praktikën shkresore të rastit të parashtruar nga ankuesi ***** (shkresa e dërguar nga ankuesi si dhe përgjigjet nga Departamenti i Administratës Publike; aktin e regjistrimit në listën e pritjes etj.), si dhe informacion se në cilën fazë është zgjidhja e kërkesës nga ana e këtij institucioni.

Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 593/2 prot., datë 14.09.2020, *“Kthim përgjigje”*, ka vënë në dispozicion shkresën me të cilën ka njoftuar Komisionerin se, në vijim të kërkesës të nëpunësit civil ***** , në përfundim të periudhës së pezullimit, si dhe zbatim të pikës 1, të nenit 56, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe pikës 17, germa “b”, të Kreut II, të Vendimit nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”*, i ndryshuar, ka vendosur transferimin e përhershëm të ankuesit ***** , në pozicionin e punës *“Përgjegjës i Sektorit të Prokurimit dhe Marrëdhënieve Kontraktuale, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile – kategoria e pagës III-a/1”*.

Pas verifikimit të dokumentacionit që shoqëron kërkesën e paraqitur, rezulton se, me aktin nr. 3926, datë 26.08.2020, *“Transferimi i përhershëm në përfundim të pezullimit”*, të Departamentit të Administratës Publike, nëpunësi ***** , është transferuar në pozicionin e punës *“Përgjegjës i Sektorit të Prokurimit dhe Marrëdhënieve Kontraktuale, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile – kategoria e pagës III-a/1”*.

Në përfundim, nga analiza në tërësi e dokumentacionit të administruar konstatohet se, veprimet e njësisë përgjegjëse dhe aktorëve të tjerë në këtë proces, janë kryer në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe pikës 17, germa “b”, të Kreut II, të Vendimit nr. 124, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, i ndryshuar.

Nga sa është parashtruar më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, arrin në përfundimin se veprimet e Departamentit të Administratës Publike, në rolin e njësisë përgjegjëse, në realizimin e procedurës së transferimit të përhershëm të nëpunësit *****, vlerësohen të kryera në përputhje me ligjin, për këtë arsye bazuar në nenin 16, pika 6, të Kreut III, “Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, kërkesa e nëpunësit *****, duhet të arkivohet.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të kërkesës nr. 593 prot., datë 09.07.2020, të nëpunësit *****, në lidhje me disa pretendime për parregullsi të kryera gjatë procesit të rikthimit të tij, në pozicionin e mëparshëm të punës, pas përfundimit të periudhës së pezullimit.
2. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, në rolin e njësisë përgjegjëse dhe kërkuesi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha